



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.110

2003

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i BSH nr.107, datë 24.12.2003	Për miratimin e rregullores “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë”..... 4757
Vendim i BSH nr.120, datë 30.12.2003	Për të miratuar rregulloren “Për administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja”..... 4759
Vendim i KKRT nr.199, datë 26.12.2003	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Rash”..... 4766
Vendim i KKRT nr.199/1, datë 26.12.2003	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Alpo”..... 4766
Vendim i KKRT nr.199/2, datë 26.12.2003	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Planet”..... 4767
Vendim i KKRT nr.199/3, datë 26.12.2003	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Abc”..... 4767
Vendim i KKRT nr.199/4, datë 26.12.2003	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Perla”..... 4768
Vendim i KKRT nr.199/5, datë 26.12.2003	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Scorpion”..... 4768

Vendim i KKRT nr.200, datë 26.12.2003	Për dhënie licence për radio vendore private “Energy”.....	4769
Vendim i KKRT nr.201, datë 26.12.2003	Për dhënie licence për radio vendore private “Argjiropolis”.....	4769
Vendim i KKRT nr.202, datë 26.12.2003	Për dhënie licence për radio vendore private “Kontakt”.....	4770
Vendim i KKRT nr.205, datë 26.12. 2003	Për dhënie licence për radio vendore private “Muzika Jonë”....	4770
Vendim i KKRT nr.206, datë 26.12.2003	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “Tv Aos”.....	4771

VENDIM
Nr.107, datë 24.12.2003

I KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI GARANCITË NË OPERACIONET KREDITUESE TË BANKËS SË SHQIPËRISË”

Kjo rregullore nxirret në përputhje dhe në zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”(neni 16 pika 1) dhe të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 44.

Neni 1
Qëllimi

1.1 Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i instrumenteve për garantimin e kredive që Banka e Shqipërisë jep për bankat e nivelit të dytë, përcaktimi i procedurave të lidhura me kontrollin e rrezikut në operacionet e politikës monetare dhe i mënyrës me të cilën këto të fundit përcaktohen dhe rregullohen.

1.2 Të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja me aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë vendosin garanci në operacionet kredituese të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

~~e-~~

1.3 Vlerësimi i garancive synon mbrojtjen e Bankës së Shqipërisë nga rreziku financiar, rritjen e efektivitetit operacional, si dhe trajtimin e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në këto operacione.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime :

“Initial margin” nënkupton që garancia e kërkuar për një transaksion është e barabartë me shumën e kredisë së akorduar bankës plus një përqindje të caktuar. Diferencimi i përqindjeve bëhet në përputhje me kohën e ekspozimit të bankës së nivelit të dytë për një transaksion të dhënë.

“Kredi e axhustuar” nënkupton shumën e kredisë së kërkuar plus marzhin fillestar.

“Haircut” nënkupton llogaritjet që bën Banka e Shqipërisë për vlerësimin e garancive mbi vlerën e tregut, duke zbritur një përqindje të caktuar që reflekton karakteristikat e letrës me vlerë, të tillë si maturimi i mbetur.

“Margin call” nënkupton se, nëse vlera e letrës me vlerë të vendosur si garanci bie nën një nivel të caktuar, u kërkohet bankave të nivelit të dytë të vendosin garanci shtesë bazuar në rivlerësimin e tyre. Në mënyrë simetrike, nëse vlera e letrave me vlerë tejkalon shumën e vendosur nga banka plus margin call, bankave të nivelit të dytë u kthehen garanci shtesë.

“Data e vlerësimit” nënkupton ditën në të cilën letrat me vlerë, të vendosura si garanci, vlerësohen.

Neni 3
Instrumentet për garantimin e kredive

Sipas kësaj rregulloreje, kreditë që Banka e Shqipërisë jep për bankat e nivelit të dytë garantohen nga letrat me vlerë të emetuara nga qeveria dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme:

a)

të jenë të tregtueshme në tregun sekondar të letrave me vlerë;

- b) të jenë të transferueshme dhe të depozitohen në një llogari të letrave me vlerë në Bankën e Shqipërisë deri në momentin e shlyerjes së kredisë;
- c) të kenë afat të mbetur deri në maturim jo më pak se 14 ditë, nga dita e shlyerjes së kredisë së marrë në Bankën e Shqipërisë.-

~~Ne~~

Neni 4 Vlerësimi i garancive

2.1 Vlerësimi i letrave me vlerë, që përdoren si garanci, bëhet duke përdorur çmimet referencë të ankandëve më të fundit të bonove të thesarit të qeverisë.

2.2 Vlerësimi i letrave me vlerë bëhet mbi baza javore, nëse operacionet për të cilat letrat me vlerë që përdoren si garanci kanë maturim më tepër se shtatë ditë.

2.3 Vlerësimi i letrave me vlerë bëhet mbi baza ditore, nëse operacionet për të cilat letrat me vlerë që përdoren si garanci kanë maturim njëditor ose përdoren në më tepër se një operacion.

Neni 5 Masat për kontrollin e rrezikut

Për përcaktimin e vlerës së letrave me vlerë që përdoren si garanci në operacionet kredituese të politikës monetare përdoren masat për kontrollin e rrezikut.

3.1 *Initial margin* aplikohet duke shtuar një përqindje mbi shumën e kredisë së kërkuar dhe shërben për përcaktimin e vlerës së garancisë. Duke marrë në konsideratë kohën e ekspozimit të Bankës së Shqipërisë, aplikohen dy përqindje të ndryshme:

- a)
për kreditë njëditore aplikohet një shtesë 8 përqind mbi shumën e kërkuar të kredisë;
- b) për kreditë me maturim më tepër se një ditë, aplikohet një shtesë 10 përqind mbi shumën e kërkuar të kredisë.

Shumës së përfituar pas aplikimit të *initial margin* do t'i referohemi me termin “kredi e axhustuar”.

3.2. *Haircuts* aplikohet duke zbritur një përqindje të caktuar nga vlera e tregut të letrave me vlerë. Në varësi të maturimit të letrave me vlerë aplikohen *haircuts* si në vijim:

- a) 3 përqind për letrat me vlerë me maturim deri në një vit;
- b) 6 përqind për letrat me vlerë me maturim mbi një vit.

Neni 6 Administrimi i vlerës së garancisë

4.1 Nëse në datën e vlerësimit të letrave me vlerë, shuma e garancisë nuk përputhet me vlerën e kredisë së axhustuar, nga Banka e Shqipërisë aplikohen margin call të cilat janë simetrike.

4.1.1 Nëse vlera e tregut të letrës me vlerë vendosur si garanci bie më tepër se 3 përqind e shumës së kredisë së axhustuar, atëherë Banka e Shqipërisë u kërkon bankave të vendosin letra me vlerë shtesë, deri në vlerën e kërkuar të garancisë.

4.1.2 Nëse vlera e tregut të letrës me vlerë vendosur si garanci në datën e vlerësimit tejkalon më tepër se 3 përqind shumën e kredisë së axhustuar, atëherë Banka e Shqipërisë mund t'u kthejë bankave letrat me vlerë shtesë, deri në vlerën e kërkuar të garancisë.

Neni 7

Masat në rast mosplotësimi të kërkesave për garanci

Në rast të mosplotësimit nga bankat e nivelit të dytë të procedurave të kërkuara për akordimin e lehtësive ose kryerjen e operacioneve në tregun e hapur nën kuadrin rregullativ në fuqi, Banka e Shqipërisë aplikon sanksionet e mëposhtme:

a) gjorbë mbi shumën e mosplotësimit të garancisë, llogaritur për maturimin e operacionit të tregut të hapur, për të cilin është vendosur garancia dhe normë interesi të kredisë lombard plus 5 pikë për qind;

b) sanksione administrative, në përputhje me ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Në rast se kredia nuk kthehet në kohë, kolaterali kalon në pronësi të Bankës së Shqipërisë, bazuar në aktmarrëveshjen e nënshkruar midis palëve për këtë qëllim.

Neni 8

Njoftim për mosplotësim të kërkesave për garanci

Në rastet e mosplotësimit të vlerës së garancisë në operacionet e bankave të nivelit të dytë me Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Operacioneve Monetare njofton Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, i cili vepron në përputhje me nenin 44 pika 2 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe me politikat që ka në dispozicion për marrjen e masave korrektuese.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Rregullorja “Për mjetet për sigurimin e detyrimit”, miratuar me vendimin nr.111, datë 10.8.1998 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.107, datë 24.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës të Shqipërisë.

KRYETARI

Shkëlqim Cani

VENDIM

Nr.120, datë 30.12.2003

**I KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR TË MIRATUAR RREGULLOREN
“PËR ADMINISTRATORËT E BANKAVE DHE TË DEGËVE
TË BANKAVE TË HUAJA”**

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1.1 Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim, për thjeshtësi për bankat dhe degët e bankave të huaja është përdorur termi “bankë”.

1.2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizmin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e bankës, si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.

1.3 Subjekte të kësaj rregulloreje janë këta administratorë:

1.3.1 anëtarët e këshillit drejtues,

~~1.3.2~~ 1.3.2 anëtarët e komitetit të kontrollit,

~~1.3.3~~ 1.3.3 drejtuesit ekzekutivë të bankës/të degës së bankës së huaj:

- a) drejtori i përgjithshëm i bankës/drejtori i degës së bankës së huaj,
- b) zëvendësdrejtori i përgjithshëm i bankës/zëvendësdrejtori i degës së bankës së huaj;
- c) drejtues departamenti/drejtorie.

1.4 Në kuptimin e kësaj rregulloreje, si administratorë të përcaktuar në nenin 1 pikat 1.3.1 dhe 1.3.2 për degët e bankave të huaja, do të konsiderohen anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe anëtarët e organeve kontrolluese të bankës mëmë, të cilët nuk janë subjekt i kësaj rregulloreje.

Neni 2

Kualifikimi, reputacioni dhe përvoja

2.1 Të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si administratorë duhet të kenë reputacion të mirë dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, për sa i përket figurës së tyre morale dhe aftësisë profesionale.

2.2 Të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar si administratorë të kenë arsimin e lartë, si rregull, në fushën e ekonomisë ose të jurisprudencës.

2.3 Nëse administratori nuk e ka arsimin e lartë në fushën e shkencave ekonomike ose të jurisprudencës, por në një fushë tjetër, atëherë ai/ajo duhet të ketë punuar në sektorin bankar, të paktën pesë vjet. Nëse ky administrator zotëron një titull/gradë shkencore në fushën e shkencave ekonomike ose juridike, atëherë, sipas rastit, ai u nënshtrohet kërkesave të paragrafit 2.5, 2.6 ose 2.7.

2.4 Administratorët zgjidhen me kriterin e profesionalizmit dhe të përvojës në:

- sektorin financiar;
- biznese me madhësi të përafërt me bankën e propozuar (totali i aktiveve);
- fushën akademike të ekonomisë ose të jurisprudencës;
- administrimin e pasurive të patundshme;
- fushën e auditimit;
- titull/gradë shkencore në fushën e shkencave ekonomike ose juridike.

2.5 Administratorët e përcaktuar në nenin 1 pikat 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.3 germat “a” dhe “b” duhet të kenë përvojë për një periudhë jo më pak se tre vjet në ushtrimin e aktiviteteve ose të funksioneve të parashikuara në pikën 2.4 të këtij neni.

2.6 Administratorët e përcaktuar në nenin 1 pika 1.3.3 germa “c” duhet të kenë përvojë për një periudhë jo më pak se dy vjet në ushtrimin e aktiviteteve ose të funksioneve të parashikuara në pikën 2.4 të këtij neni.

2.7 Administratorët e përcaktuar në nenin 1 pika 1.3.2, përveç kërkesave të pikës 2.4 të këtij neni, duhet të kenë përvojë për një periudhë jo më pak se tre vjet në kryerjen e veprimtarisë së kontabilitetit dhe/ose të auditimit.

Neni 3

Kërkesa dhe dokumentacioni

3.1 Kërkesa për miratimin nga Banka e Shqipërisë të kandidaturës së propozuar bëhet nga banka, në bazë të vendimit:

- a) të asamblesë së aksionerëve për anëtarët e këshillit drejtues dhe për anëtarët e komitetit të kontrollit të bankës;
- b) të këshillit drejtues të bankës për administratorët e përcaktuar në nenin 1 pika 1.3.3;
- c) të organit vendimmarrës të bankës mëmë ose personit të autorizuar prej tij për emërimin e administratorëve të degës të bankës së huaj, të përcaktuar në pikën 1.3.3.

3.2 Kërkesa, ku përcaktohet pozicioni i propozuar i administratorit, shoqërohet me

Formatted: Bullets and Numbering

dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) një kopje e noteruar e diplomës së arsimit të lartë, si rregull, në ekonomi ose në jurisprudencë;
- b) CV-ja e firmosur sipas formularit nr.1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
- c) të dhëna të detajuara për veprimtarinë tregtare dhe për bizneset e tyre për shtatë vjetët e fundit, si dhe ato në të cilat ata kanë pjesëmarrje influencuese;
- d) të paktën një rekomandim lidhur me aftësinë profesionale (nga persona eprorë, akademikë dhe/ose nga punëdhënësit e mëparshëm);
- e) deklaratë personale në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;
- f) deklaratë personale e çdo administratori se gjatë aktivitetit të tij të punës nuk ka kryer veprimtari që bien në kundërshtim me rastet e parashikuara në nenin 21 pika 2 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- g) deklaratë personale për shkallën e interesave me përfitim material ose të marrëdhënieve me përfitim material me bankën që e propozon;
- h) 1. për administratorët shtetas shqiptarë, dëshmi penaliteti e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës të Shqipërisë dhe vërtetime nga gjykata dhe prokuroria që nuk janë në ndjekje penale ose në proces gjyqësor penal;

2. për administratorët shtetas të huaj, kërkohen vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të vendeve të tyre ku të vërtetohet se nuk janë dënuar më parë, nuk janë në ndjekje penale ose në proces gjyqësor penal;

i) për administratorët shtetas të huaj, dokumentacioni i mësipërm të jetë i noteruar dhe i vërtetuar pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme ose pranë çdo institucioni tjetër sipas legjislacionit përkatës të vendit të tyre dhe më tej të përkthehet në shqip dhe të noterohet;

j) për personat e huaj të propozuar për administratorë, të paraqitet në Bankën e Shqipërisë kopja e kërkesës së depozituar pranë organeve përkatëse për marrjen e lejes së qëndrimit dhe të lejes së punës. Me paraqitjen e këtij dokumenti dhe me plotësimin e të gjitha kërkesave të tjera, Banka e Shqipërisë jep një miratim të përkohshëm (deri në gjashtë muaj) për administratorin, i cili me marrjen e këtij miratimi ka të drejtën e përfaqësimit të bankës. Vetëm pas paraqitjes së dokumentit zyrtar të lejes së qëndrimit dhe të lejes së punës nga organet përkatëse në Bankën e Shqipërisë, jepet miratimi për emërimin e administratorit.

Neni 4 Kufizimet

4.1 Nuk lejohet të caktohen si administratorë të bankës dhe lirohen nga kjo detyrë administratorët ekzistues, në rastet e parashikuara në nenin 21 pika 2 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

4.2 Administrator i bankës nuk mund të pranohet një person i cili ka ndërprerë marrëdhëniet juridike me bankën apo me çdo subjekt tjetër që kryen veprimtari bankare për shkak të shkeljeve të akteve ligjore e nënligjore, për shkak të shpërdorimit të detyrës, si dhe për paaftësi në kryerjen e funksioneve drejtuese.

4.3 Kryetari i këshillit drejtues nuk mund të jetë njëkohësisht edhe administrator i përcaktuar sipas nenit 1 pika 1.3.3.

4.4 Administratorët e përcaktuar sipas nenit 1 pika 1.3.3 mund të jenë njëkohësisht anëtarë të këshillit drejtues, por ata duhet të përbëjnë jo më shumë se një të tretën e tij.

4.5 Administratorët e përcaktuar sipas nenit 1 pika 1.3.3 nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të komitetit të kontrollit.

4.6 Nuk lejohet qenia si administrator, sipas pikës 1.3.3, njëkohësisht në më shumë se një bankë.

4.7 Nuk lejohet qenia si administrator, sipas pikës 1.3.2, i personave të punësuar tek eksperti kontabël i autorizuar i bankës.

4.8 Deri 2/3 e administratorëve të përcaktuar sipas nenit 1 pika 1.3.2 mund të jenë njëkohësisht

edhe anëtarë të këshillit drejtues të bankës.

Neni 5 **Miratimi**

5.1 Bankat i emërojnë përfundimisht administratorët vetëm pas marrjes paraprakisht të miratimit nga Banka e Shqipërisë.

5.2 Banka e Shqipërisë jep miratimin e saj brenda 30 ditëve pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë për marrjen e miratimit të administratorit të propozuar.

5.3 Banka, për çdo ndryshim pozicioni të administratorëve të miratuar, njofton me shkrim Bankën e Shqipërisë duke paraqitur:

- dokumentin e emërimit sipas nenit 3 pika 3.2 të kësaj rregulloreje;
- CV-në e plotësuar sipas formularit nr.1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, për të vlerësuar eksperiencën e administratorit.

5.4 Banka e Shqipërisë mund të kërkojë në mënyrë konfidenciale, nëpërmjet Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes, arsyet e largimit nga puna në bankë të administratorit të saj.

5.5 Miratimi i administratorit bëhet nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë.

5.6 Për parregullsi, të vërejtura pas miratimit të administratorit, Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të rishqyrtuar edhe një herë miratimin e administratorit në një kohë të mëvonshme, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe vetëm me miratim të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe për një periudhë jo më larg se një vit kalendarik nga dita e miratimit të parë.

Neni 6 **Refuzimi**

6.1 Kur vërtetohet se administratori i propozuar nuk plotëson kushtet e kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e miratimit.

6.2 Vendimi i refuzimit të administratorit të bankës merret prej administratorit përgjegjës të Bankës së Shqipërisë. Një kopje e vendimit i dërgohet bankës/degës së bankës së huaj brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 7 **Revokimi**

7.1 Revokimi i miratimit të dhënë nga Banka e Shqipërisë bëhet kur:

- a) vërtetohet njëri nga rastet e parashikuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje;
- b) personi ka paraqitur informacion të rremë për marrjen e miratimit nga Banka e Shqipërisë për emërimin si administrator i bankës;
- c) në mbështetje të nenit 5 pika 5.6 të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë konstaton se emërimi i administratorit nuk është bërë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

7.2 Vendimi i revokimit të miratimit të dhënë nga Banka e Shqipërisë për administratorin e bankës merret nga administratori përgjegjës i Bankës së Shqipërisë. Një kopje e vendimit i dërgohet bankës brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 8 **Shkarkimi**

8.1 Banka e Shqipërisë ka të drejtë që, në përputhje me nenin 44 pika 2 germa “e” të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe me aktet rregullative të miratuara, të kërkojë shkarkimin dhe/ose largimin e një ose të gjithë administratorëve të bankës/degës së bankës së huaj, nëse vëren shkelje të parashikuara në ligj dhe/ose aktet rregullative të miratuara nga Banka e

Shqipërisë.

8.2 Kërkesa për shkarkim dhe/ose largim, drejtuar organeve vendimmarrëse të bankës, nënshkruhet nga administratori përgjegjës i Bankës së Shqipërisë.

Neni 9

Regjistri i administratorëve

9.1 Çdo miratim, revokim, shkarkim ose largim i administratorit të bankës, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, regjistrohet në një regjistër të veçantë në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

9.2 Çdo refuzim i miratimit të administratorit të bankës, regjistrohet në një listë të veçantë në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

Neni 10

Dispozita të fundit

10.1 Bankat përshtatin kodin e rregullave të etikës për administratorët jo më vonë se 60 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

10.2 Administratorët e miratuar nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullores “Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.13, datë 17.2.1999, nuk janë subjekt i kësaj rregulloreje. Për rizgjedhjen e tyre të plotësohen detyrimet e kësaj rregulloreje.

10.3 Rregullorja “Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.13, datë 17.2.1999 dhe ndryshimet e saj, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.17, datë 1.3.2000, shfuqizohen.

10.4 Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.120, datë 30.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Shkëlqim Cani

FORMULARI 1
CURRICULUM VITAE

1. Të dhëna personale

Emri:
Mbiemri:
Datëlindja:
Vendlindja:
Shtetësia:
Adresa e vendbanimit aktual:
Gjendja civile: ! ! I/e martuar ! ! beqar/e ! ! I/e divorcuar

2. Arsimi i kryer

Ju lutemi filloni nga arsimi i mesëm

1. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	19xx – 19xx
Diploma ose certifikata e fituar	
2. Emri i institucionit dhe adresa	
Datat e ndjekjes së studimeve	19xx – 19xx
Diploma ose certifikata e fituar	

3. Njohja e gjuhëve të huaja

Gjuha e huaj	Njohja në lexim	Njohja në të folur	Njohja në të shkruar

Shënoni vlerësimin me numrat nga 5 – 1 (5 = shumë mirë, 4 = mirë, 3 = mjaftueshëm etj.).

4. Pjesëmarrje në këshilla drejtuese/ në shoqata profesionistësh

5. Kurse kualifikimi të kryera

6. Eksperienca profesionale

Përshkrimi i detajuar i punësimit. Ju lutemi filloni nga punëdhënësi më i fundit

Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
Natyrë e punësimit	a. i punësuar ! ! b. i vetëpunësuar ! ! c. i papunë ! ! d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time) ! !
Emri dhe adresa e punëdhënësit	
Natyrë e biznesit (publik ose privat)	
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
Përgjegjësitë (të detajuara)	
Arsyet e largimit	a. Dorëheqje ! ! b. Shkurtim i vendit të punës ! ! c. Dalje në pension ! ! d. Përfundimi i kontratës së punësimit ! !

Formatted: Bullets and Numbering

Formatted: Bullets and Numbering

Formatted: Bullets and Numbering

Formatted: Bullets and Numbering

Formatted: Bullets and Numbering

Formatted: Bullets and Numbering

	e. Pushim nga puna f. Të tjera Specifiko	!__! !__!
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)		
Natyrë e punësimit	a. i punësuar b. i vetëpunësuar c. i papunë d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time)	!__! !__! !__! !__!
Emri dhe adresa e punëdhënësit		
Natyrë e biznesit (publik ose privat)		
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)		
Përgjegjësitë (të detajuara)		
Arsyet e largimit	a. Dorëheqje b. Shkurtim i vendit të punës c. Dalje në pension d. Përfundimi i kontratës së punësimit e. Pushim nga puna f. Të tjera Specifiko	!__! !__! !__! !__! !__! !__!
Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)		
Natyrë e punësimit	a. i punësuar b. i vetëpunësuar c. i papunë d. ndjekje e studimeve me shkëputje nga puna (full-time)	!__! !__! !__! !__!
Emri dhe adresa e punëdhënësit		
Natyrë e biznesit (publik ose privat)		
Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)		
Përgjegjësitë (të detajuara)		
Arsyet e largimit	a. Dorëheqje b. Shkurtim i vendit të punës c. Dalje në pension d. Përfundimi i kontratës së punësimit e. Pushim nga puna f. Të tjera Specifiko	!__! !__! !__! !__! !__! !__!

Emri dhe mbiemri i administratorit të propozuar.

(firma)

Data

VENDIM
Nr.199, datë 26.12.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “RASH”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit në licencën nr.025/FML të subjektit radiofonik "RASH" të emrit të subjektit të licencuar, me vendimin nr.29, datë 30.10.2000 të KKRT-së nga shoqëria Edisud sh.a. në shoqëria Edisud Radio-TV sh.p.k.
2. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.025/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin "Edisud Radio-TV" sh.p.k., për radion "RASH".
3. Kushtet e licencës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr.199/1, datë 26.12.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK "ALPO"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.020/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin fizik Aristotel Petro, për radion "Alpo".
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr.199/2, datë 26.12.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCES SË SUBJEKTIT RADIOFONIK "PLANET"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.031/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin fizik Armando Osmanlli, për radion “Planet”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr.199/3, datë 26.12.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “ABC”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.019/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin fizik Armand Baze, për radion “ABC”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr.199/4, datë 26.12.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “PERLA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “ Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.030/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Valezeri” sh.a., për radion “Perla”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr.199/5, datë 26.12.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “SCORPION”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.028/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Scorpion” sh.p.k., për radion “Scorpion”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr.200, datë 26.12.2003

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO VENDORE PRIVATE “ENERGY”
SUBJEKTIT: “NRG MULTIMEDIA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin nëntor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “NRG Multimedia” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve

radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen stuktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr.201, datë 26.12.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “ARGJIROPOLIS”
SUBJEKTIT: “RADIO-TV ARGJIROPOLIS” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin nëntor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Radio-TV Argjiropolis” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Gjirokastrës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr.202, datë 26.12.2003

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO VENDORE PRIVATE “KONTAKT”
SUBJEKTIT: “MEDIA KONTAKT” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë e radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin nëntor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Media Kontakt” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të

kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr.205, datë 26.12. 2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “MUZIKA JONË”
SUBJEKTIT: “RADIO MUZIKA JONË” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin nëntor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Radio Muzika Jonë” sh.p.k., me vendndodhjen në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM
Nr.206, datë 26.12.2003

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TV AOS”
SUBJEKTIT: Z.ARJAN XHANI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin nëntor, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, Z.Arjan Xhani me vendndodhje në Përmet, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 16.1.2004

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi: 150 lekë